



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 210/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Sori - Al” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50034-02-11-2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe qëndrat në varësi të tij”, me fond limit 268.475.020 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k.
Lagja “Haxhias”, Rruga “Ismail Zyma”, Zona Kadastrale 8525, objekti me nr. Pasurie A, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Sori – AL” sh.p.k.
Rruga “Beqir Luga”, Pallati Nr. 3, Shk. 1/1, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-50034-02-11-2020, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe qendrat në varësi të tij*”, me fond limit 268.475.020 lekë

(pa TVSH), zhvilluar në datën 21.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 21.04.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. “Sori -AL” sh.p.k. | 255.040.508,80 lekë, kualifikuar |
| 2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. | 268.374.280 lekë, skualifikuar |
| 3. “Kevin Konstruksion” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 05.05.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

[...]

-Antari i BOE “DION-AL” SHPK skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2, gërma “e” të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri që të provojë se disponon një ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit, certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi për të dy ambientet e paraqitura janë jashtë afatit të vlefshmërisë.

II.4. Në datën 11.05.2020, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ngre pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes pretendon se:

[...]

Sa i përket pikes se pare refuzimit te BOE Olta Sharra pf dhe Dion – Al sh.p.k. Nga KVO nepermjet sistemit e date 05.05.2020 jemi njoftuar per refuzimin e ofertes tone per arsyet e meposhteme: Antari i BOE “DION-AL” SHPK skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2, gërma “e” të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri që të provojë se disponon një ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit, certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi për të dy ambientet e paraqitura janë jashtë afatit të vlefshmërisë. Kundërshtojme vendimin e mesipër si pa argumentuar, te pabazuar ne ligj dhe ne shkelje te barazise ne tendera.

Ne kerkesat per kualifikim pjese e DST percaktohej:

2. Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e shërbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

a) Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte:

- Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

- Dokumentacioni se verteton huaperdorjen: Kontrate huaje.

- Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate qiraje.

b) Licencen e kategorise "II I.A. I - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ", leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

c) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per kete ambient.

d) Akt miratimi higjieno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

e) Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

f) Operatori ekonomik duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit.

BOE ka paraqitur ne prokurim per plotesimin e kerkeses se mesiperme nje ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit me Vendndodhje: Spitali Rajonal Durres ne rolin e qeradhenesit per dhenie me qera objekti me siperfaqe 185 m2. (bashkengjitur dokumentacioni i paraqitur). Persa me lart konstatohet se:

a. Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte:

- Dokumentacioni qe verteton pronesine:

Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

Ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

b. Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen:

- Kontrate huaje.

c. Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate qiraje.

(Paraqitur dhe pranuar nga KVO kontrata e qerases me nr,2137 nr kol 1127/4 date 04.05.2019)

b. Licencen e kategorise "III.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ", leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

(Paraqitur dhe pranuar nga KVO licenca LN-3344-06-2017)

c. Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit te gatimif dhe shperndarjes se ushqimit, per kete ambient.

(Paraqitur dhe pranuar nga KVO leja PN-4993-04-2017)

d. Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent ngarkuar me ligj.

(Paraqitur dhe pranuar nga KVO akti i miratimit higjeno sanitar nr, 41 date 16.03.2018)

e. Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent te ngarkuar me ligj.

(Paraqitur dhe kundershuar nga KVO Certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin nr, 4001 prot date 06.04.2020)

f. Operatori ekonomik duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit.

(Paraqitur dhe pranuar nga KVO deklarata perkatese).

Persa me lart konstatohet se i vetmi element i cili kundershohet nga KVO dhe mbi te cilin ky komision bazon refuzimin e tij eshte germa "e" e pikes 2 per Certifikaten per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Paraqitur dhe kundershuar nga KVO Certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin nr. 4001 prot date 06.04.2020.

Ne vijim ju informojme se nje veprim i tille pra refuzimi i ofertes tone eshte jo vetem i pa mbeshtetur ne fakte e dokumenta te paraqitura nga BOE por dhe ne shkelje te plote te legjislacionit per prokurimin publik.

KVO pretendon se Certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj eshte jashte afatit te vlefshmerise duke prezumuar se Certifikata me nr. 4001 prot date 06.04.2020 e paraqitur ne proceduren e prokurimit te zhvilluar ne date 21.04.2020 eshte jashte vlefshmerise kjo sepse ne te njejten shkrese te leshuar ne date 06.04.2020, mbi bazen e vendimit nr 166 te dates 02.04.2020, bazuar ne kontrollin e ushtruar nga inspektori Xhemil Ribaj ne date 31.03.2020, KVO ka konstatuar sc kjo certifikate ka vlefshmeri deri ne date 05.03.2020. Renditja e dateve:

Kontroli nga Oficer insp. Parandalimi Xhemil Ribaj	Date 31.03.2020
--	-----------------

Vendimi per leshimin e certifikates numer 166	Date 02.04.2020
---	-----------------

Leshimi i shkrese nga protokolli i institucionit nr 4001prot	Date 06.04.2020
--	-----------------

E vlefshme nga mornenti i Ieshimit deri	Date 05.03.2020
---	-----------------

Ne respekt te Autoritetit tuaj Kontraktor konstatojme qartesisht se anetaret e KVO jo vetem qe nuk e kane analizuar nje shkrese te tille me kompetence por me dashje kane vendosur ta quajne atejashte afatit te vlefshmerise. Si eshte e mundur qe askush nga anetaret e KVO nuk ka drejtuar pyetjen se perse nje akt I leshuar ne date 06.04.2020 ka vlefshmeri deri ne date 05.03.2020 pra per periudhen e kaluar? Ne kuptimin ligjor kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Gjithashtu, kriteret per kualifikim i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Ne rastin konkret pyetja eshte nese: BOE e ploteson kushtin per Ambjentin catering jo vetem sepse ne percaktimet e DST nuk kerkohet ambjent per secilin nga anetaret e BOE te paraqitur ne prokurim, pra

ne rastin konkret Olta Sharra (PF) gjithashtu e ka paraqitur nje ambjent, (nje nga qellimet baze te bashkepunimit eshte pikerisht ky parim) por dhe sepse dokumentacioni i paraqitur nga Dion-Al sh.p.k. ne certifikaten e mbrojtjes nga zjarri eshte brenda afatit te vlefslunerise dhe ceshtja e vlefshmerise eshte thjesht nje lapsus drejtshkrimor.

A e ka bere KVO pyetjen nese ambjenti ne fjale i paraqitur nga Dion-Al sh.p.k. eshte apo jo ne perputhje me kushtet e percaktuara ne ligjin nr. 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin"?

A eshte ky ne fund te fundit qellimi i AK ne lidhje me krijimin e bindjes se ofertuesi eshte i besueshem per te realizuar kontraten apo thjesht qellimi eshte skualifikimi i BOE Olta Sharra (PF) dhe Dion-AL sh.p.k.?

Nese vertet KVO do te kishte ne prioritet parimet e LPP dhe qellimin e AK per vleresimin nese Certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin nr. 4001 prot date 06.04.2020 ateher KVO duhet ta analizonte ate, duhet te bente nje renditje te datave si me lart dhe nese do ishte nevoja te kerkonte shpjegime, te merrte kohe per leterkembime me autoritetet shtetore qe kane leshuar certifikaten per te konstatuar ne fakt ate qe eshte detyra e KVO: nje vleresim te drejte dhe te barabarte te dokumentacionit te paraqitur nga konkuresit ne prokurim.

Ne nenin 45/1 te ligjit 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" theksohet: Neni 45 Kontrolli teknik pas perfundimit te punimeve I. Inspektoret e sherbimit te MZSH-se, ne perfundim te punimeve le objektit, kontrollojne zbatimin e dispozitave te ketij ligji dhe te detyrave te lena ne projektin per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin. Nese jane respektuar kerkesat e projektit, drejtori/sheft i sektorit te sherbimit te MZSH-se jep certifikaten e sigurise nga zjarri.

Ne nenin 42/2 te ligjit 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" theksohet: Neni 42 Moszbatimi i projektit per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetirnin 2. Punonjesit e sherbimit te MZSH-se mbajne pergjegjesi per leshimin e certifikates se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetirnin kur nuk jane zbatuar detyrat e parashikuara ne projekt.

Ne VKM 914 date 24.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit public" te ndryshuar neni 66 percaktohet: Neni 66 Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave (Shtuar fjale ne piken 2, ndryshuar fjali ne piken 4, shtuar fjali ne piken 8 me Vkm nr. 797, date 29 12 2017) 2. Kohezgjatja e procedures se vleresimit nuk duhet te kaloje 15 (pesembedhjet) dite, pervec rasteve te tjera te cilesuara ndryshe ne keto rregulla. Ne rast se komisionit te vleresimit te ofertave i lind nevoja per verifikime ose ndryshime te nje apo me shume anetareve, afati I vleresimit pezullohet ne momentin e paraqitjes se kerkeses per verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku eshte pezulluar me marrjen e pergjigjes apo zyrtarizimit te anetarit/anetareve. 3. Pas mbylljes se seances publike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nese eshte e nevojshme, komisioni i vleresimit te ofertave kerkon sqarime nga ofertuesit, te cilat duhet te jene me shkrim ose te reflektuara ne procesverbal.

Ne cilin rast eshte dokumentuar nga ana e KVO nje veprim i tille per verifikimin e nje dokumenti qartesisht te rregullt?

A nuk eshte qellimi i KVO verifikimi nese operatoret ekonomik i permbushin kushtet per realizimin e kontrates?

Nga ana jone si BOE ju paraqesim nje dokumentacion te kerkuar me shkrese te thjeshte nga ne, organi kompetent i ngarkuar me ligji per leshimin e certifikates e ne kete rast Drejtoria e MZSH Durres prane

Bashkise Durres perigiigien e te ciles e kemi marrc ne date 06.05.2020 (pra brenda nje dite nga vlercsimi) dhe te cilen po jua dergojme bashkengjitnr ankimit tone ku theksohet: Referuar "certifikates per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi" nr 166 date 02.04.2020 me nr 4001 prot, Durres, date 06.04.2020 e leshuar nga Drejtoria e MZSH Durres sqarojme se kjo certificate eshte e vlefshme per 1-(nje) vit deri ne date 30.03.2021. Data e shtypur ne certificate eshte si rrjedhoje e nje lapsusi nga ana e drejtorise tone. Subjekti me nipt K6791730JH eshte kontrolluar ne date 31.03.2020 nga inspektori Xhemil Ribaj dhe pasi ka plotesuar te gjitha kushtet eshte paisur me certificate. Persa me lart ne kuptim te LPP sa i perket qellimit se operatoret ekonomike kualifikohen pasi permbushin kerkesat per kualifikim konstatohet qarte qe dokumenti i mesiperm eshte Brenda vlefshmerise ndryshe nga sa kane konstatuar anetaret e KVO.

Sa i perket pikes se dyte Kualifikimit te operatorit ekonomik Sori-Al sh.p.k.

Ne gjykim te vleresimit te mesiperm per vendimin e KVO ku nje kohe te shpejte eshte skualifikuar BOE Olta Sharra (PF) & Dion-Al sh.p.k. si dhe nga eksperiencat e meparshme operatori ekonomik Sori-Al sh.p.k. nuk i ploteson kerkesat per kualifikim e pikcrisht:

Sori-Al sh.p.k, nuk ploteson kerkesat per kualifikim per: Ofertuesi duhet te deklaroje se:

a) Eshte i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ka ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit. Ne rastin kur ofertuesi eshte nje organizate jofitimprurese, duhet te deklaroje se eshte i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 "Per Organizatat jo Fitimprurese".

b) nuk eshte ne proces falimentimi, (stafusi aktiv)

c) nuk eshte denuar per shkelje penale, ne perputhje me Nenin 45/1 te LPP,

ç) nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, per vepra qe lidhen me veprimtarine profesionale.

d) ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatirneve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet te deklaroje se i ploteson te gjitha kerkesat e renditura me siper nepermjet paraqitjes se nje vetedeklarate me shkrim.

Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentat ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe.

Ne rastet e bashkimit te operateve ekonomike, cdo anetar i grupit duhet ie dorezoje vetedeklaraten e lartpermendur,

Kriteret e Pergjithshme per Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 7.

Ne cdo rast, autoriteti kontraktor ka te drejte te kryeje vcrifikimet e nevojshme mbi vertetcsine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper,

Vec kesaj, nese oferta dorezohet nga nje bashkim operateresh ekonomike, duhet te dorezohcn:

a. Marreveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operateve ekonomike eshte krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posacme.

Sori-Al sh.p.k. nuk ka dorezuar a. Formulari i Ofertes, sipas Shtojces 1; Ne perputhje me DST

Sori-Al sh.p.k. nuk ka dorezuar Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3 (ne vleren 2% te fondit te marreveshjes kuader) Ne perputhje me DST dhe legjislacionin perkates Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3 (ne vleren 2% te fondit te marreveshjes kuader)

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundershtim me formatin per c. Deklaraten per paraqitje oferte te pavarur, sipas Shtojces 1/1

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundershtim me formatin per ç Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojces 5;

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundershtim me formatin per d. Deklarate mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojces 6;

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundershtim me formatin per dh. Deklarate mbi garantimin e zbatueshmerise se dispozitave ligjore ne marredheniet e punes sipas Shtojces 7/1;

Sori-AI sh.p.k. nuk ka deklaruar te gjitha vendndodhjet e pageses se OSHEE sipas adresave te QKB si dhe ka detyrime per: e. Vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundershtim me formatin per ISO-t:

1. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate e vlefslune qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

2. Certifikate e vlefshme e shoqerise ISO 22000 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme - Sistemet e menaxhimit te sigurise ushqimore. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3. Certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e rrenaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001 ose ISO 45001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

4. Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten te vlefshme ISO 14001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme - Sisteme te menaxhimit te mjedisi. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise,

Ne rastin e bashkimit le operatoreve ekonomik; sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave le puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper le realizoj sipas akimarreveshjes.

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte debitor ne kundershtim me kerkesat per kualifikim per:

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje te deklarave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlere mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vlere se fondit limit.

2. Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve: 2016, 2017, 2018 te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore.

Sori-AI sh.p.k. nuk permbush kriteret per:

3.3 Kapaciteti teknik

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi persherbimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e

vleres se fondit limit. Realizimi i sherbimeve te ngjashme duhet te vertetohet me dokumentacionin si me poshte:

- Kur per sherbimet e ngjashme jane realizuar me institucione shteterore, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e leshuar nga institucioni shteteror per realizimin e sherbimeve ose faturat tatimore te shitjes. .
- Kur per sherbimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturat perkatese tatimore te shitjes ku te jene shenuar datat, shumat dhe sasite e sherbimeve te furnizuara.

Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteret per nje ambient ku ushtron veprimtarine per shkak te parregullsise ne dokumentacionin qe verteton pronesine, Licencen e kategorise "II.1.A.1 per objektin ne fjale, Leje e mjedisi (e tipit C, kodi III.1.A, Akt miratimi higjeno – sanitar per kete ambient, Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin per ambientin e paraqitur, deklaraten e plotesimit te standarteve etj.

2. Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqirnit, per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

g) Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte:

➤ Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certificate e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

Ose

- kontrata e shitblerjes

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise,

➤ Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen:

- Kontrate huaje.

➤ Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate qiraje.

h) Licencen e kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", leshuar nga Qendra Kornbetare e Biznesit.

i) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per kete ambient.

j) Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

k) Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

1) Operatori ekonomik duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe galimit te ushqimit.

Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteret per minimumi 2 mjete ne kundertshtim me kerkesat per kualifikim:

3. Operatori ekonomik duhet te disponoje minimumi 2 (dy) mjete transporti frigoriferik, per transportin e produkteve ushqimore, ne pronesi ose me qira, te vertetuar me dokumentacionin perkates, per secilin mjet si me poshte:

➤ Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certificate e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- cdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësise sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që verteton marrjen me qira:
- Kontrate qiraje.

a) leje qarkullimi,

b) certifikate e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

c) police për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

d) akt miratimi higjieno - sanitar.

Sori-Al sh.p.k, është debitor në sigurime shoqërore e tatime deri ditën e zhvillimit të procedurës si dhe nuk plotëson kriterin e mëposhtem:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 32 (tridhjetë e dy) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Janar 2020 - Mars 2020. Për të vertetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.
- Listë pagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.

Sori-Al sh.p.k, nuk plotëson kriterin e mëposhtem duke patur shkelje të afteve të vlefshmerive të kontratave, librezave shëndetsore etj. Gjithashtu bazuar në dyshime të arsyeshme Mercollog/Kimist/teknolog i paraqitur nga Sori-Al në prokurim rezultoi i dy punësuar në subjekte të tjera, duke rënë kështu ndesh me parashikimet e kodit të punës dhe në këtë mënyrë ky punonjës nuk mund të jetë i disponueshëm për procedurën në fjalë për shkak të angazhimit në më shumë se një biznes.

4.1 Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Kuzhinier	4
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinierë/Shërbyes gatimi	25
4	Shofer	2
Total		32

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetsore. b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetsore. c) Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontratë pune dhe librezat e punës, librezë shëndetsore. d) Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeteve kategorisë – B. e) Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listë pagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kërkuar .

Ka mungesa ne deklaratat e kerkuara per tu paraqitur ne kundershtim me kerkesat e meposhtme:

5. Operatori ekonomik duhet te deklaroje disponimin ose mundesine e disponimit te materialeve dhe mjeteve profesionale te domosdoslune/inventari i imet, te kerkuara ne shtojcen 9 te DT.

6. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit (AKU); operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Ne perfundim kerkojme nga Autoriteti Kontraktor te vendose rivleresimin e procedures Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan dhe qendrat ne varesi te tij me REF-50034-02-11-2020 duke vendosur:

1. Kualifikimin e BOE Olta Sbarra (PF) & Dion-Al sh.p.k,

2. S'kualifikimin e OE Sori-Al sh.p.k.

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 18.05.2020, me anë të shkresës nr.745/3 prot. dhe 745/2 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. duke e pranuar pjesërisht atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për sa i përket kualifikimit të ofertës së tij ekonomike dhe ka refuzuar pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për sa i përket kualifikimit të operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. Konkretisht, autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes ka argumentuar si më poshtë:

[...]

1.Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar skualifikimin per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 2, germa "e" ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "2. Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet te paraqese dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë: Dokumentacioni qe vërteton pronësinë: - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose - kontrata e shitblerjes; ose - kontrata e dhurimit; ose - çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: - Kontratë huaje. Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: - Kontratë qiraje. b) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. c) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per këtë ambient. d) Akt miratimi higjieno – sanitar per këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. e) Certificate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. f) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit."

Me pretendimin si vijon: [...] ".... BOE ka paraqitur ne prokurim per plotesimin e kerkeses se mesiperme nje ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit me vendodhje Spitali Rajonal Durres ne rolin e qiradhenesit per dhenie me qera objekti me siperfaqe 185 m2 (bashkengjitur

dokumentacioni i paraqitur) per sa me lart kostatohet se i vetmi element i cili kundeshon KVO dhe mbi te cilin ky komision bazon refuzimin e tij eshte germa "e" e pikes 2 per Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Paraqitur dhe kundeshuar nga KVO Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin nr.4001 prot i pa mbeshtetur ne fakte e dokumenta te paraqitura nga BOE por dhe ne shkelje te plate te legjislacionit per prokurimin publik. KVO pretendon se Certificata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj eshte jashte afatit te vlefshmerise duke prezumuar se Certificata me nr. 4001 prot date 06.04.2020 e paraqitur ne proceduren e prokurimit te zhvilluar me date 21. 04.2020 eshte jashte vlefshmerise kjo sepse ne te njejten shkrese te leshuar ne date 06.04.2020, mbi bazen e vendimit nr 166 te dates 02.04.2020, bazuar ne kontrollin e ushtruar nga inspektori Xhemil Ribaj ne date 31.03.2020, KVO ka konstatuar se kjo certi.ftkate ka vlefshmeri deri ne date 05. 03.2020. Renditja e datave: Kontrolli nga Oficer insp. Parandalimi Xhemil Ribaj-Date 31.03.2020, Vendimi per leshimin e certifikates numer 166-Date 02.04.2020 Leshimi i shkrese nga protokolli i institucionit nr 4001 prof Date 06.04.2020 E vlefshme nga momenti i leshimit deri-Date 05.03.2020. Ne respekt te Autoritetit tuaj Kontraktor konstatojme qartesisht se anetaret e KVO Jo vetem qe nuk e kane analizuar nje shkrese te tille me kompetence por me dashje kane vendosur ta quajne ate jashte afatit te vlefshmerise. Si eshte e mundur qe askush nga anetaret e KVO nuk ka drejtuar pyetjen se perse nje akt i leshuar ne date 06.04.2020 ka vlefshmeri deri ne date 05.03.2020 pra per periudhen e kaluar? Ne kuptimin ligjor kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Gjithashtu, kriteret per kualifikim i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te opratoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne rastin konkret pyetja eshte nese: BOE e ploteson kushtin per Ambjentin catering jo vetem sepse ne percaktimet e DST nuk kerkohet ambjent per secilin nga anetaret e BOE te paraqitur ne prokurim, pra ne rastin konkret Olta Sharra (PF) gjithashtu e ka paraqitur nje ambjent, (nje nga qellimet baze te bashkepunimit eshte pikerisht ky parim) por dhe sepse dokumentacioni i paraqitur nga Dion-Al sh.p.k. ne certifikaten e mbrojtjes nga zjarri eshte brenda afatit te vlefshmerise dhe ceshtja e vlefshmerise eshte thjesht nje lapsus drejtshkrimor. A e ka bere KVO pyetjen nese ambjenti ne fjale i paraqitur nga Dion-Al sh.p.k. eshte apo Jo ne perputhje me kushtet e percaktuara ne ligjin nr. 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin"? A eshte ky ne fund te fundit qellimi i AK ne lidhje me krijimin e bindjes se ofertuesi eshte i besueshem per te realizuar kontraten apo thjesht qellimi eshte skualifikimi i BOE Oita Sharra (PF) dhe Dion-AL sh.p.k.? Nese vertet KVO do te kishte ne prioritet parimet e LPP dhe qellimin e AK per vleresimin nese Certificata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin nr. 4001 prot date 06. 04.2020 ateher KVO duhet ta analizonte ate, duhet te bente nje renditje te datave si me Zart dhe nese do ishte nevoja te kerkonte shpjegime, te merrte kohe per leterkembime me autoritetet shtetore qe kane leshuar certifikaten per te konstatuar ne fakt ate qe eshte detyra e KVO: nje vleresim te drejte dhe te barabarte te dokumentacionit te paraqitur nga konkuruesit ne prokurim. Ne nenin 45/1 te ligjit 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" theksohet: Neni 45 Kontrolli teknik

pas perfundimit te punimeve 1. Inspektoret e sherbimit te MZSH-se, ne perfundim te punimeve te objektit, kontrollojne zbatimin e dispozitave te ketij ligji dhe te detyrave te zena ne projektin per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin. Nese jane respektuar kerkesat e projektit, drejtori/shefi i sektorit te sherbimit te MZSH-se jep certifikaten e sigurise nga zjarri. Ne nenin 42/2 te ligjit 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" theksohet: Neni 42 Moszbatimi I projektit per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin 2. Punonjesit e sherbimit te MZSH-se mbajne pergjegjesi per leshimin e certifikates se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin kur nuk jane zbatuar detyrat e parashikuara ne projekt. Ne VKM 914 date 24.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar neni 66 percaktohet: Neni 66 Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave (Shtuar, fjale ne piken 2 , ndryshuar: fjali ne piken 4 shtuar fjali ne piken 8 me vknz nr 797, date 29.12.2017) 2. Kohezgjatja e procedures se vleresimit nuk duhet te kaloje 15 (pesembedhete) dite, pervec rasteve te tjera te cilesuara ndryshe ne keto rregulla. Ne rast se komisionit te vleresimit le ofertave i find nevoja per verifikime ose ndryshime te nje apo me shume anetareve, afati i vleresimit pezullohet ne momentin e paraqitjes se kerkeses per verifikim opo ndryshim dhe rifillon aty ku eshte pezulluar me marrjen e pergjigjes apo zyrtarizimit te anetarit/anetareve. 3. Pas mbylljes se seances publike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nese eshte e nevojshme, komisioni i vleresimit te ofertave kerkon sqarime nga ofertuesit, te cilat duhet te jene me shkrim ose te reflektuara ne procesverbal. Ne cilin rast eshte dokumentuar nga ana e KVO nje veprim i tille per verifikimin e nje dokumenti qartesisht te rregullt? A nuk eshte qellimi i KVO verifikimi nese operatoret ekonomik i permbushin kushtet per realizimin e kontrates? Nga anajone si BOE ju paraqesim nje dokumentacion te kerkuar me shkrese te thjeshte nga ne, organi kompetent i ngarkuar me ligj per leshimin e certifikates e nif kiite rast Drejtoria e MZSH Durres pranc Bashkise Durres pergjigjen e te ciles kemi marre ne date 06.05.2020 (pra brenda nje dite nga vleresimi) dhe te cilen po jua dergojme bashkiingjitur ankimit tone ku theksohet: Referuar "certifikates per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi" nr 166 date 02.04.2020 me nr 4001 prot, Durres, date 06.04.2020 e leshuar nga Drejtoria e MZSH Durres sqarojme se kjo certificate eshte e vlefshme per 1 (nje) vit deri ne date 30.03.2021. Data e shtypur ne certifikat eshte si njedhoje e nje lapsusi nga ana e drejtorisc tone. Subjekti me Npt K67917301H eshte kontrolluar ne date 31.03.2020 nga inspektori Xhemil Ribaj dhe pasi ka plotesuar te gjitha kushtet eshte pajisur me certificate. Per sa me lart ne kuptim te LPP sa i perket qellimit se operatoret ekonomik kualifikohen pasi permbushin kerkesat per kualifikim konstatohet qarte se dokumenti i mesiperm eshte brenda vlefshmerise ndryshe nga sa kane konstatuar anetaret e KVO. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 05.05.2020, arsyet e skualifikimin e tij si vijon: "Antari I BOE "DION-AL" SHPK skualifikohet pasi nuk permbush kriterin e percaktuar ne piken 2, germa "e" te kapacitetit teknik te dokumentave te tenderit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne permbushje te ketij kriteri qe te provoje se disponon nje ambient ku

ushtron veprimtarine e sherbimit, certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi per te dy ambientet e paraqitura janejashte afatit te vlefshmerise."

Komisioni i Shyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK dhe konstatoi: Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 2, germa "e" percaktohet se operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilin nder te tjera duhet te paraqese dhe Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SIIPK ka dorezuar kontrate bashkepunimi nr. Repertori 1511, nr. Koleksioni 862 date 17/04/2020 per "Bashkim te perkohshem te shoqerive". Ne kete kontrate bashkepunimi perqindja e kryerjes se sherbimeve eshte ndare "Olta Sbarra" PF 24 % dhe "Dion-Al" shpk 76% sipas zerave te preventivit bashkengjitur kontates. Nga verifikimi rezulton se ne sistemin e prokurimit elektronik per anetarin "Dion-A" SHPK te BOE jane dorezuar dokumentacioni me emertimi: "Ambient ushtrimi aktiviteti " dhe "Dion - AL_3.3.2_ambient_katering". Ne dokumentacioni me emertim "Dion-AL_3.3.2_ambient_katering" pjese perberese e tij jane: Licensa LN-9437-04-2015 me kodin II.1.A me emertim pershkruar te veprimtarise "Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez (katering); leje mjedisore PN-8480-11-2014 tipi C per "Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqirnore te gatshme dhe gjysme te gatshme"; certifikata per mbrojtje nga zjarri dhe shpetimi me nr. Sh-6213/1 prot date 08.04.2019 me afat vlefshmerie 28.03.2020 (i pavlefshem); akt miratimi higjeno sanitar nr.1478; kontrat qiraje nr.7825 Rep dhe nr. 2357 Kol date 28.11.2019; dhe dokumenta te tjera bashkengjitur si vertetime noteriale, planimetria etj.

Ne dokumentacioni me emertim "Ambient per ushtrim aktiviteti" pjese perberese e tij jane: kontratë qiraje nr. Rep 2137 dhe nr. Kol 1127/4 date 4.05.2019 lidhur midis qiradhenesit Spitali Rajonal Durres dhe qiramarresi "Dion-Al" SHPK; Licensa LN-3344-06-2017 me kodin II.1.A me emertim pershkruar te veprimtarise "Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez (katering); leje mjedisore PN-4993-04-2017 tipi C per "Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysme te gatshme; Akt miratimi "Leje mjedisi tipi C" nr. 80 Prot me nr. Identifikimi te lejes 28 date 14.04.2017; Akt- miratimi higjeno sanitar nr.41.

Ne perrnbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojce nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 2 germa "e" ofetuesi Dion-Al" SHPK pjese e BOE, ka dorezuar ne lidhje me ambientin e marre me qira me dhe dokumentin e kerkuar ne germen "e" te ketij kriteri me konkretisht, certifikën per mbrojtje nga zjarri dhe shpetimi nr. 4001 date 06.04.2020.

Ne certifikaten nr.166 date 02.04.2020 e leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi (Bashkia Durres), percaktohet se eshte e vlefshme deri ne 05.03.2020. Nga verifikimi rezulton se sipas certifikates nr. 166 Z. XH.R me date 31.03.2020 ka bere rikontrollin e subjektit. Pas rikontrollit dhe konstatimeve te bera eshte leshuar certifikata nr.166 date 02.04.2020 e cila me pas eshte protokolluar me nr.4001 Prot date 06.04.2020. Nisur nga verifikimi I kryer nuk mundet që nje certifikatë per te cilën kontrolli eshte bere ne datën 31.03.2020 dhe e cila eshte leshuar ne 02.04.2020 te kete afat te vlefshmerie deri ne 05.03.2020.

Ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar me emertim "Ambient per ushtrim Aktiviteti" ofertuesi ka arritur te permbush kriteret e percaktuara ne piken 2 seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" ne shtojcen nr. 8 te dokumentave te tenderit.

Per arsyet e me siperrne pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK pranohet.

2. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori Al" sh.p.k. per mospermbushje te kriterëve te percaktuara ne shtojcen nr.8 ne :Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit" pika 1, ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse". b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër. Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme.. "

Me pretendimin si vijon: [...] "... Nuk plotëson kërkesat per kualifikim"

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtuara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si me poshte: Per ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofetuesi "Sori Al" SHPK ne permbushje te kriterëve te percaktuar ne Shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit", pika 1, ne dokumentet e tenderit ku percaktohet se: keto kriteret duhet te plotësohen me dorëzimin e vetedeklarates me shkrim te subiektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 7, ka dorezuar "Deklaraten mbi permbushjen e Kriterëve te Pergjithshme".

Nga verifikimi i deklarates se paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga ofetuesi "Sori Al" SHPK, rezulton se ajo eshte dorezuar ne perputhje me Shtojcen nr.7 sipas formatit standard të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

3. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK për mospërbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 1 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1; b. Sigurimi i ofertes, sipas Shtojcës 3 (në vlerën 2% të fondit të marrëveshjes kuadër); c. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1 ç. Deklaratë mbi përbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5; d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6; dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1; e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Me pretendimin si vijon: [...] "Se pari...nuk ka dorëzuar formularin e ofertes sipas shtojcës nr. 1 me përputhje me DST". Se dyti: nuk ka dorëzuar sigurimin e ofertes, sipas shtojcës 3, (në vlerën 2% të fondit të marrëveshjes kuadër) në përputhje me DST dhe legjislacionin përkatës, sigurimi i ofertes, sipas shtojcës 3 (në vlerën 2% të fondit të marrëveshjes kuadër)." Se treti: ... nuk përbush kriteret dhe është në kundërshtim me formatin për deklaraten për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 1/1. " Se katri ...nuk përbush kriteret dhe është në kundërshtim me formatin për deklarate mbi përbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 5. "Se pesti: " ... nuk përbush kriteret dhe është në kundërshtim me formatin për deklarate mbi konfliktin e interesit sipas shtojcës 6. "Se gjashti: ... nuk përbush kriteret dhe është në kundërshtim me formatin për deklarate mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas shtojcës 7/1" Se shtati: ... nuk ka deklaruar të gjitha vendodhjet e pagesës së OSHEE sipas adresave të QKB si dhe ka detyrime për Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. "

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi rezultoi se:

1. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK në përbushje të kriterit të përcaktuar në shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 1, gjerësisht "a" në dokumentat e tenderit, ka dorëzuar: "Formularin e ofertes ekonomike në përputhje me shtojcën nr. 1 të dokumentave të tenderit.

2. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK në përbushje të kriterit të përcaktuar në shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 1 gjerësisht b në dokumentat e tenderit ka dorëzuar: "Formularin e sigurimit të ofertes i cili është në përputhje me shtojcën 3 dhe me përcaktimin e bërë në "Njoftimin e Kontrates" pika 3.2 ku përcaktohet: "Sigurimi i Ofertes: 2% e Fondit limit (i zbatueshem në rastin e procedurave

te prokurimit me vlere me te larte se kufiri i larte monetar, ne rast se kerkohet nga autoriteti kontraktor) Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, sipas Shtojces 3. Vlora e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte 5,369,500.4 (pese milion e treqind e gjashtedhjetë e nente mije e pesëqind pike kater) Leke (shuma e shprehur ne fjale)."

3. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 1, germa "c" ne dokumentat e tenderit, ka dorezuar: "Deklarate per paraqitje oferte te pavarur" ne perputhje me shtojcen 1/1 te dokumentave te tenderit.

4. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 1, germa "c" ne dokumentat e tenderit, ka dorezuar: "Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike" ne perputhje me shtojcen nr. 5 te dokumentave te tenderit.

5. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 1, germa "d" ne dokumentat e tenderit ka dorezuar: "Deklarate mbi konfliktin e interesit" ne perputhje me shtojcen nr. 6 te dokumentave te tenderit.

6. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 1, germa "dh" ne dokumentat e tenderit ka dorezuar: "Deklarate mbi garantimin e zbatueshmerise se dipozitive ligjore ne marredheniet e punes" ne perputhje me shtojcen nr. 7/1 te dokumentave te tenderit.

7. Ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 1, germa "e" ne dokumentat e tenderit ka dorezuar "Vertetim Debie" nr. 895 Prot date 02/04/ 2020 ku vertetohet se nga verifikimet e kryera ne sistemin e faturimit per kontratat titullar/perdorues i se ciles eshte firma "Sori -Al" A.F rezulton te kete ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri ne daten 31.03.2020 duke perfshire dhe faturen koherente te muajit Shkurt 2020.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

4. Ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK per mospermbushje te kriterëve te percaktuar shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomik" pikat 1, 2, 3, 4 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: " 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë e vlefshme qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. 2. Certifikatë e vlefshme e shoqërisë ISO 22000 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme - Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. 3. Certifikatë e vlefshme qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë ne pune ISO 18001 ose ISO 45001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. 4. Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten të vlefshme ISO 14001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) atehere kur kjo eshte e

aplikueshme - Sisteme të menaxhimit të mjedisi. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes."

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk përmbush kriteret dhe është në kundërshtim me formatet me ISO".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertes së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë: Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Sori-Al" SHPK në përmbushje të kriterëve të përcaktuara shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik", pikat 1, 2, 3, 4 në dokumentat e tenderit, ka dorëzuar: Certifikatë UNI EN ISO 9001; Certifikatë UNI EN ISO 22000, Certifikatë OHSAS dhe Certifikatë UNI EN ISO 14001. Certifikatat e dorëzuara nga ofertuesi janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 1, 2, 3, 4 të seksionit 3.1 "Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik", "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" në dokumentat e tenderit.

Për arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

5. Ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK për mospërbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pikat 1 dhe 2 ndryshuar me shtojcat nr.1 dhe nr. 2 të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: "1- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e të cilës të jete jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. 2- Kopje të certifikuarave të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore."

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk përmbush kriteret dhe është debitor në kundërshtim me kërkesat për kualifikim"

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave, pasi verifikoi dokumentat e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertes së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorezuar në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterëve të përcaktuara shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", seksioni 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pikat 1 dhe 2 në dokumentet e tenderit, ndryshuar me shtojcën nr.1 dhe nr. 2 të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka dorezuar:

Në përmbushje të pikës nr. 1 ofertuesi "Sori Al" SHPK ka dorezuar "Vertetim për xhirot e tre viteve të fundit" sipas përcaktimit të dokumentave të tenderit 2016, 2017, 2018 ku nga verifikimi rezultoi se vlera mesatare e tyre është jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Gjithashtu në përmbushje të pikës nr. 2 ofertuesi "Sori AL" SHPK ka dorezuar kopje të bilanceve 2016, 2017, 2018 të shoqëruar dhe me konfirmimin nga autoriteti përkatës tatimor.

Për arsyt e mësipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

6. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK për mospërmbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 1 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vertetohet me dokumentacionin si më poshtë: Kur për shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetimin e leshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes. Kur për shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse. "

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk përmbush kriteret".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sbarra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sisternit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezultoi se ofertuesi "Sori Al" SHPK në përmbushje të kriterit ka dorezuar kontratë shoqëruar dhe me "Vertetimet për realizimin e kontratës". Nga verifikimi i kontratëve dhe vertetimeve të dorezuara ofertuesi përmbush kriterin për dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Për arsyt e mësipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

7. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK për mospërmbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 2 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: "2. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e

sherbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet te paraqese dokumentacionin e mëposhtëm: a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë: - Dokumentacioni që vërteton pronësinë: - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose - kontrata e shitblerjes; ose - kontrata e dhurimit; ose - çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. - Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: - Kontratë huaje. - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: - Kontratë qiraje. b) Licencën e kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. c) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për këtë ambient. d) Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. e) Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. f) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit."

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk përmbush kriteret për një ambient ku ushtron veprimtarinë për shkak të parregullsive në dokumentacionin që vërteton pronësinë, licencën e kategorisë II.1.A.1 për objektin në fjalë, leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, akt miratimi higjieno-sanitar për këtë ambient, certifikate për mbrojtjen e zjarrit dhe shpëtimin për ambientin e paraqitur, deklaratën e patesimit të standarteve etj". Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e hequr në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Sori-Al" SHPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 2 në dokumentat e tenderit nga dorëzuar "Kontratë Qiraje" për të provuar se disponon ambientin e kërkuar në këtë pikë. Gjithashtu bashkëngjitur kontatës së qirase ofertuesi ka dorëzuar si vijon: Akt miratimi-higjieno sanitar nr. 459 i lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj; certifikate sigurie për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi me nr. 674; license LN-2396-11-2016 me kodin II.1.A (I) me emërtim "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (katering)"; leje mjedisore me kodin III.1.A me emërtim përshkrues të veprimtarisë, leje mjedisi të tipit C për aktivitetin gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme. Gjithashtu në sistemin e prokurimit elektronik ofertuesi "Sori-Al" në përmbushje të gërmes "f" pika 2 seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" ka dorëzuar deklaratën mbi plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

Për arsye të mësipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet,

8. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK per mospermbushje te kriterave te percaktuar shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 3 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: " 3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, për secilin mjet si më poshtë: Dokumentacioni që vërteton pronësinë: - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose - kontrata e shitblerjes;

ose - kontrata e dhurimit; ose - çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: Kontratë qiraje. a) leje qarkullimi, b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, d) akt miratimi higjieno – sanitar".

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk permbush kriteret per minimumi 2 (dy) mjete ne kundeshtim me kerketat per kualifikim".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara ne anekse mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 05.05.2020, kualifikimim e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 3 ne dokumentat e tenderit ka dorezuar dokumentacionin si vijon: "Kontrat qiraje" me ane te ciles verteton se disponon 2 (dy) mjete transporti frigoriferik, per transportin e produkteve ushqimore. Gjithashtu bashkengjitur kontrates se qerese, per te dyja mjetet ofertuesi ka dorezuar ne permbushje te kriterave te percaktuara ne gjerat "a", "b", "c" dhe "d", Lejet e qarkullimit, certifikatat e kontrollit teknik te mjeteve rrugore; policat per sigurimin e detyrueshem te mjeteve per pergjegjesi ndaj paleve te treta dhe aktet e miratimi higjieno-sanitar.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

9. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK per mospermbushje te kriterave te percaktuar shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 4 ndryshuar me shtojcen nr. 1 te publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik, ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te kete Jo me pak se 32 (tridhjetë e dy) persona te punesuar ne sektorin e sherbimit te ushqimit, te siguruar per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese: Nje vertetim nga administrata tatimore per numrin mesatar te punonjesve per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020."

Me pretendimin si vijon: [...] "eshte debitor ne sigurimet shoqerore e tatimet deri ne ditën e zhvillimit te procedures si dhe nuk ploteson kriterin".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara ne anekese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se ofertuesi "Sori-Al" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik", pika 4 ne dokumentat e tenderit, ndryshuar me shtojcen nr. I te publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik, "Vertetim per kontributete e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesit-E-Sig 02/a" dhe listepagesat per periudhen Dhjetor 2019-Shkurt 2020. Nga verifikimi i dokumentacionit te sipercituar rezulton se ofertuesi "Sori Al" SHPK e ka perrmbushur kriterin e percaktuar ne piken 4 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik", "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", shtojca 8.

Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit DOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

10. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK per mospermbushje te kriterëve te percaktuar shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 4.1 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	4
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi	25
4	Shofer	2
	Total	32

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore. b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore. c)Për ndihmës kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore. d) Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B. e) Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhen e kerkuar. "

Me pretendimin si vijon: [...] "nuk ploteson kriterin duke patur shkelje te afateve te vlefshmerise se kontratave, librezave shendetesore etj. Gjithashtu bazuar ne dyshime te arsyshme Mercellog/ Kimist/teknolog i paraqitur nga Sori-Al ne prokurim rezulton i dypunesuar ne subjektje te tjera , duke

rene kështu ndesh me parashikimet e kodit të punës dhe në këtë mënyrë ky punonjes nuk mund të jetë i disponueshëm për procedurën në fjalë për shkak të angazhimit në më shumë se një biznes".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Sori -Al" SHPK në përmbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik", pikë 4.1 në dokumentat e tenderit ka dorëzuar dokumentacionin në përputhje me kriterin. Me konkretisht ofertuesi ka dorëzuar kontratat e punës për 4 kuzhinier, 2 kryeguzhinier bashkeshoqeruar me diplomat, librezat shëndetsore dhe librezat e punës. Kontrata pune për 26 ndihmes kuzhinier, bashkeshoqeruar me librezat shëndetsore dhe librezat e punës. Kontrata pune për dy shoferë bashkeshoqeruar edhe me lejet e drejtimit perkatese. Gjithashtu ofertuesi ka dorëzuar kontrata pune për 3 kimistë bashkeshoqeruar me diplomat, librezat e punës dhe librezat shëndetsore. Punonjësit për të cilët janë lidhur kontratat figurojnë në listepagesat e shoqërisë të dorëzuar dhe në përmbushje të pikës 4 në seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik", "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" në dokumentat e tenderit.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

11. Ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al", SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Sori-Al" SHPK për mospërmbushje të kriterëve të përcaktuar shtojcën nr.8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 5 dhe 6 në dokumentat e tenderit, ku përcaktohet: "Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imet, të kërkuara në shtojcën 9 të DT ; Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore."

Me pretendimin si vijon: [...] "ka mundësi në deklaratat e kërkuara për të paraqitur në kundëstym me kërkesat".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Sori - Al" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "Sori-Al" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 05.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Sori-Al" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Sori -Al" SHPK ne permbushje te kriterave te percaktuara ne pikat 5 dhe 6 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" ka dorezuar: "Deklarate per mjetet profesionale dhe inventarin e imet" ku dhe ka deklaruar se disponon mjetet profesionale dhe inventarin e imet te domosdoshem, te kerkuar ne shtojcen 9 "Specifikimet teknike" ne dokumentat e tenderit. Ofertuesi ka dorezuar deklarate per operimin sipas standarteve ne fuqi per sigurine ushqimore, ku ka deklaruar se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kerkeseve ligjore. Dokumentacioni i dorezuar eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit BOE "Olta Sharra" PF dhe "Dion-Al" SHPK nuk pranohet.

Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.

II.6. Në datën 26.05.2020, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se:

[...]

Per vendimin e KVO ne objektin e mesiperm kemi paraqitur ankese protokolluar me nr. 745 prot date 11.05.2020 prane autoritetit kontraktor duke kerkuar:

- 1. Kualifikimin e BOE Olta Sharra (PF) & Dion-Al sh.p.k.*
- 2. S'kualifikimin e OE Sori-Al sh.p.k.*

Me shkrese nr. 745/3 date 18.05.2020 "Dergohet vendimi mbi ankesen", Vendim i cili mban numrin 745/2 date 18.05.2020, duke pranuar vetem piken 1 te ankeses dhe duke mos pranuar piken 2. Persa me lart ju paraqesim ankimin tone duke kerkuar s'kualifikimin e opertorit ekonomik Sori-Al sh.p.k. pasi bazuar si dhe nga eksperiencat e meparshme, si edhe bazuar ne dyshime te arsyeshme, operatori ekonomik Sori-Al sh.p.k. nuk i ploteson kerkesat per kualifikim e pikerisht per arsyet e meposhtme:

1.Se pari, operatori ekonomik Sori-Al sh.p.k. nuk ka deklaruar te gjitha vendndodhjet e pageses se OSHEE sipas adresave te QKB si dhe ka detyrime per: e. Vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Referuar shkreses nr. 745/2 protokolli date 18.05.2020, kthim pergjigje mbi trajtimin e ankeses tone, nder te tjera eshte shprehur se: "Ofertuesi "Sori-Al" shpk ne permbushje te kriterit ka dorezuar Vertetim Debie nr. 895 protokolli date 2/4/2020 ku vertetohet se nga verifikimet e kryera ne sistemin e faturimit ku per kontratat titullar i se cilave eshte Sori-Al shpk rezulton te kete 0 eke detyrime per faturat e energjise elektrike vlere e llogaritur deri ne 31.3.2020 duke perfshire faturen koherente te muajit shkurt 2020.

Ne lidhje me arsyetimin e mesiperm te autoritetit kontraktor, veme re, se autoriteti kontraktor nuk ka shqyrtuar ne thelb as pretendimet e shoqerise tone si edhe as dokumentacionin e dorezuar ne teresi nga

operatori ekonomik "Sori- Al" shpk. Konkretisht, referuar vertetimit nr. 895 protokolli, kontratat e deklaraura nuk jane vetem ne emer te subjektit juridik Sori- Al shpk por edhe ne emer te individid, konsumator familjar Alma Tafani.

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonornike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe dote prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ndersa ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerketat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit...."

Ne nenin 9 ("Pagesa dhe afati per kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, te kontrates se miratuar me Vendimin nr. 109, date 21.10.2011 te ERE "Per miratimin e kontrates se furnizimit me energji elektrike te klienteve jofamiljare", percaktohet shprehimisht qe: "Klienti dote paguaje detyrimin e percaktuar ne faturen mujore te konsumit te energjise elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur eshte rasti, kamate vonesat perkatese dhe pagesen e rilidhjes se energjise, jo me vone se ditet e fundit kalendarike te muajit pasardhes te atij te faturuar." Sqarojme se nder kontratat e deklaruar nga operatori ekonomik "Sori Al" sh.p.k., i perkasin personave fizike (Alma Tafani) te cilet e paguaje energjine elektrike me tarifa familiare. Duke qene se shoqeria "Sori- AL" sh.p.k ushtron veprimtari biznesi, por pagesen e energjise elektrike e ka bere sipas tarifave familjare, nukjemi ne kushtet e parashikuara ne nenin 9 te Vendimit nr.109 te ERE-s si me siper cituar, e cila i referohet kontratave te furnizimit me energji elektrike te klienteve jofamiljare. Sipas shkreses nr.6287/1 prot., date 30.03.2015 te OSHEE-se, (korespondence e Komisionit te Prokurimit Publik) si me siper cituar, kriteri baze qe duhet te plotesohet per pajisjen me Vertetim Debie eshte deklarimi vullnetar i te gjitha kontratave te furnizimit me energji elektrike per te gjitha objektet e ushtrimit te aktivitetit te subjektit sipas ekstraktit te QKR-se, detyrim i cili nuk eshte zbatuar nga ana e shoqerise "Sori-Al" sh.p.k e cila ka sjelle si pasoje mospagimin e differences se detyrimit te lindur midis tarifimit si biznes dhe atij familjar.

Pra operatori ekonomik "Sori- AL" sh.p.k., me dokumentacionin e dorezuar prej tij nuk e ploteson kriterin e lartpermendur te percaktuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, pasi ka paraqitur nje dokument per kontratat e furnizimit me energji elektrike te klienteve familjare, ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi per kontraten e furnizimit me energji elektrike te operatoreve ekonomike, te cilet i nenshtrohet tarifave mete larta te pagimit te energjise elektrike.

Permes veprimeve te saj, shoqeria "Sori- Al" shpk ka shkaktuar dem ekonomik OSHEE Sha si edhe ka indicie per kryerjen e vepres penale te vjedhjes se energjise elektrike, e parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal ku parashikohet se: "Vjedhja e energjise elektrike ose impulseve telefonike, demtimi i matesit, si dhe cdo nderhyrje tjeter e paligjshme dhe e paautorizuar ne sistemin e matjes apo ne rrjetin elektrik ose rrjetin telefonik, e kryer 93 me qellim perfitimi te paligjshem, perben veper penale dhe denohet me burgim deri ne tre vjet. Kur Igo veper penale kryhet ne bashkepunim, me shume se nje here, ose nga perdoruesit jo familjare te energjise elektrike ose te rrjetit te sherbimit telefonik, denohet me burgim nga nje deri ne pese vjet." Pra, ne rastin konkret, shoqeria ka vjedhur energjine elektrike, duke konsumuar energji elektrike si konsumator jo familjar per aktivitetin e gatimit te ushqimit dhe ka kryer pagesat referuar tarifave si konsumator familjar.

Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe K.PP ne vendime te ngjashme, si shembull vendimin K.PP438/2015 [...].

2. Se dyti, ne lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, ashtu sikunder kemi parashtuar edhe pretendime prane autoritetit kontraktor, Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte debitore ne kundërshtim me kërkesat per kualifikim per: "Kopje te deklarave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.

Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve: 2016, 2017, 2018 te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore."

Referuar shkreses nr. 745/2 protokolli date 18.05.2020, kthim pergjigje mbi trajtimin e ankeses tone, nder te tjera eshte shprehur se: "Ofertuesi "Sori-Al" shpk ka dorezuar kopje te bilanceve te viteve 2016, 2017, 2018 te konfirmuar nga autoriteti perkates tatimor. Ne lidhje me arsyetimin e mesiperm te autoritetit kontraktor, veme re, se autoriteti kontraktor nuk ka shqyrtuar ne thelb as pretendimet e shoqerise tone si edhe as dokumentacionin e dorezuar ne teresi nga operatori ekonomik "Sori- Al" shpk. Nga verifikimet e kryera nga ana e shoqerise tone ne regjistrin tregtar te shoqerise Sori Al shpk konstatojme se kjo e fundit ne deklarimin e pasqyrave financiare nuk ka dorezuar ne asnje rast prane administrates tatimore raportin e ekspertit kontabel per vitet 2016, 2017, 2018.

Referuar dispozites ligjore ne fuqi ne nenin 41, te Ligjit 10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar",

i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Personat juridike qe detyrohen per auditimin ligjor te pasqyrave financiare Detyrohen te kryejne auditimin ligjor te pasqyrave financiare vjetore, perpara publikimit te tyre, nga eksperte kontabel ose shoqeri audituese, parashikohet shprehimisht se: Neni 41 Personat juridike qe detyrohen per auditimin ligjor te pasqyrave financiare Detyrohen te kryejne auditimin ligjor te pasqyrave financiare vjetore, perpara publikimit te tyre, nga eksperte kontabel ose shoqeri audituese: a) te gjitha shoqerite tregtare, pavaresisht nga forma e tyre, te cilat zbatojne standardet nderkombetare te raportimit financiar; b) te gjitha shoqerite aksionare, te cilat zbatojne per raportimin financiar standardet kombetare te kontabilitetit; c) shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, te cilat zbatojne per raportimin financiar standardet kombetare te kontabilitetit, kur, ne mbyllje te periudhes kontabel, per dy vite radhazi, tejkalojne dy prej tre treguesve te meposhtem: i) totali i aktiveve te bilancit, ne mbyllje te periudhes kontabel perkatese, arrin ose e kalon shumen prej 50 milione lekesh; ii) shuma e te ardhurave nga veprimtaria ekonomike (garkullimi) ne ate periudhe kontabel arrin ose e kalon shumen prej 100 milione lekesh; iii) ka, mesatarisht, 30 te punesuar gjate periudhes kontabel

Ne nenin 46, pika 1 germa "c" e ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "[...] Operoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operoret ekonomike vertetojne se zoterojne kapacitetet ekonomike e financiare per te permbushur kontraten, me ane te deklarave bankare ose, kur nevojitet, nepermjet vertetimit per sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes se bilanceve financiare ose te pjeseve te shkeputura nga bilancet, nje deklarate te xhiros se pergjithshme te shoqerise dhe, ne rast nevojje, te xhiros se realizuar nga veprimtarite e ngjashme me objektin e

kontrates qe dote prokurohet per nje periudhe deri ne 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion eshte i mundur. [...]"

Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rrene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji.

Referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik, vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, rnakinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatorët ekonomike pjesemarrës ne procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.

Konstatojme se, referuar bilanceve te shoqerise "Sori- Al" shpk, megjithese kjo e fundit megjithese per periudhen 2016, 2017, 2018 permbush dy nga tre kushtet kumulative te nenit 41 germa "c" te ligjit nr. 10091/2009 ate te shumes se te ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) ne ate periudhe kontabel arrin ose e kalon shumen prej 100 milione lekesh; si edhe mesataren prej 30 te punesuar gjate periudhes kontabel nuk ka dorezuar ne proceduren e prokurimit bilancet e shoqerise ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi, pra shoqeruar me raportin e ekspertit kontabel, duke rende ndesh me parashikimet e ligjit te posacem.

3. Se treti, ne shtojcen 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" eshte parashikuar se: Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

a) Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte:

- Dokumentacioni qe verteton pronesine:

- Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

- Dokumentacioni se verteton huaperdorjen: Kontrate huaje.

- Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

- Kontrate qiraje.

b) Licencen e kategorise "II I.A. I - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ", leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

c) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, per zhvillimin

e aktivitetit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per kete ambient.

d) Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

e) Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

j) Operatori ekonomik duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme, operatori ekonomik Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteret per nje ambient ku ushtron veprimtarine per shkak te parregullsise ne dokumentacionin qe verteton pronesine, Licencen e kategorise "II.1.A.1 per objektin ne fjale, Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin per ambientin e paraqitur, deklaraten e plotesimit te standarteve etj,

Ne lidhje me licencen e kategorise II.1.A.1 sqarojme se referuar verifikimeve te kryera ne regjistrin e lejeve dhe licencave, informacion publik ne Qendren Kombetare te Biznesit, Licenca e mesieprme eshte leshuar per kryerjen e aktivitetit ne mjedisin e disponuar ne Qarkun Vlore, nderkohe qe bazuar ne dyshime te arsyeshme shoqeria ka deklaruar si te disponueshem ne proceduren e prokurimit objektin e disponuar me qira ne Spitalin Berat per te cilen disponon njeherazi edhe Lejen e tipit C me kodin III.1.A. Edhe ne hipotezen se ne permbushje te kriterave te vecanta ka dorezuar dokumentacion ne lidhje me mjedis ne qytetin e Vlores, serish, leja e tipit C eshte leshuar per mjedisin ne qytetin e Beratit. Theksojme se per shkak te sepcifikes se ofrimit te sherbimit te gatimit, licencimi i shoqerive i nenshtrohet rregullimit strikt, te lincencimit vetem per vendin e ushtrimit te aktivitetit, ndaj ne dorezimin e dokumentacionit duhet te kete perputhje mes mjedisit te pershtatshem te deklaruar edhe lejeve dhe licencave te leshuara. Bazuar ne ligji nr. 10081 date 23.2.2009 "Per lejet dhe licencat" i ndryshuar, licenca leshohet per vendin e kryerjes se aktivitetit, per rrjedhoje duhet te kete perputhje midis mjedisit te marre me qira per zhvillimin e aktivitetit dhe licencimit te vendit te zhvillimit te aktiviteti.

4. Se katerti, ne dokumentet e procedures se prokurimit eshte parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet te kete jo me pak se 32 (tridhjetë e dy) persona te punesuar ne sektorin e sherbimit te ushqimit, te siguruar per periudhen Janar 2020 - Mars 2020. Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Nje vertetim nga administrata tatimore per numrin mesatar te punonjesve per periudhen Janar 2020 - Mars 2020.

- Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore per periudhen Janar 2020 - Mars 2020.

1.1 Punonjesit e punesuar ne sektorin e sherbimit te ushqimit duhet te kene minimalisht 1 vit eksperience pune sipas profesioneve ne tabelen e meposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	4
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinier/Sherbyes gatimi	25
4	Shofer	2
	Total	32

Per punonjesit me profesionet e mesiperme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

a) Per kuzhinierin: diplome ose certificate kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, libreze shendetsore.

- b) Per mercollogun/kimistin/teknologun: diplome ose certificate kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, libreze shendetsore.
- c) Per ndihmes kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, libreze shendetsore.
- d) Per shoferin: kontrate pune, libreze pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria - B.
- e) Punonjesit me profesionet e mesiperme duhet te figurojne ne listpagesat e operatorit ekonomik per periudhen e kerkuar.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme Sori-Al sh.p.k. nuk ploteson kriterin e meposhtem duke patur shkelje te afteve te vlefshmerive te kontratave, librezave shendetsore etj. Dokumentacioni i dorezuar per 4 guzhinere, dy krye guzhiniere dhe 26 ndihmes guzhiniere nuk eshte ne perputhje me dokumentet e procedures se prokurimit.

Gjithashtu bazuar ne dyshime te arsyeshme Mercollog/Kimist/teknolog i paraqitur nga Sori-Al ne prokurim rezulton i dy punesuar ne subjekte te tjera, duke rene keshtu ndesh me parashikimet e kodit te punes dhe ne kete menyre ky punonjes nuk mund te jetë i disponueshem per procedure ne fjale per shkak te angazhimit ne me shume se nje biznes.

Ne nenin 90 te "Kodit te Punes", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 11.1. Kohezgjatja maksimale e oreve shtese percaktohet ne kontraten kolektive ose kontraten individuale te punes. "Punedhenesi mund te kerkoje kryerjen e oreve shtese te punes, por jo me shume se 200 ore ne vit". 2. Nuk mund te kerkohet kryerja e oreve shtese Javore kur punemarresi ka kryer 48 ore pune ne Jave. Ne raste te vecanta, per nje periudhe deri ne 4 muaj, mund te punohet me shume se 48 ore ne Jave, por koha mesatare Javore e punes, per kete periudhe, nuk duhet te jete me shume se 48 ore". 3. Keshilli I Ministrave vendos rregulla te vecanta per kryerjen e oreve shtese per punet qe jane vecanerisht te veshtira ose te demshme per shendetin. 3/1. Ndalohet kryerja e oreve shtese te punes nga grate shtatzena dhe pas lindjes se femijes, derisa femija te mbushë moshën 1 vjec. 3/2. Ndalohet kryerja e oreve shtese per personat me aftesi te kufizuar, per shkaqe objektivisht te justifikuara, qe lidhen meshkallen e aftesisë se tyre te kufizuar dhe natyren e punes per te cilen kerkohen oret shtese". 4. Me autorizimin e Inspektoratit te Punes, kohezgjatja maksimale e oreve shtese mund te tejkalohet ne rastet e forces madhore ose te puneve urgjente ne dobi te popullsisë.

Ne interpretim te bazes ligjore same sipër, gjykojme se kohezgjatja ditore normale e punes eshte jo me pak se 8 ore dhe numri maksimal i oreve shtese eshte 48 ore pune ne jave. Nje person punon ne nje subjekt te dyte per aq ore sa nuk tejkalohet numri maksimal i oreve shtese.

Ne nenin 46, pika 1, germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: [...]. Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: [...]

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorama te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshrne per t'u permbushur nga operatorët ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatorët ekonornike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen site papranueshrne, ne mbeshetjetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne të cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret

per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshrne per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonornike pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor do te konsideroje nje oferte te vlefshrne, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerketat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme, tre kimistet e deklaruar jane te dy punesuar me kohe te plote prane subjekteve te tjera private, ndersa nje prej tyre eshte e puneusar gjithashtu edhe ne adminsitraten publike. Autoriteti kontraktor ne menyre te qellimshme nuk ka shqyrtuar ne thelb pretendimet e shoqerise tone, por ka sqaruar ne menyre te pergjithshme elementet formale te permbushjes se kriterëve pa qendruar ne elementet substanciale te tyre. Kerkojme kryerjen e nje hetimit dhe verifikimi prane administrates tatimore.

Sori-Al sh.p.k. nuk ka dorezuara. Formulari i Ofertes, sipas Shtojces 1; Ne perputhje me DST.

Gjithashtu, bazuar ne dyshime te arsyeshme, operatori ekonomik "Sori- Al" shpk nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit/pranimit pasi:

Sori-Al sh.p.k. nuk ka dorezuar Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3 (ne vleren 2% te fondit te marreveshjes kuader) Ne perputhje me DST dhe legjislacionin perkates

Sigurimi i ofertes, sipas Shtojces 3 (ne vleren 2% te fondit te marreveshjes kuader)

Sigurimi i ofertes i dorezuar nuk eshte ne perputhje me shtojcen 3, pasi ne shtojcen 3 te dokumenteve te procedures se prokurimit eshte parashikuar:

Marrim persiper te transferojrne ne llogarine e [emri i autoritetit kontraktor] vleren e siguruar, brenda 15 (pesembedhete) diteve nga kerketa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkese te perrnende mosperrnbushjen e njerit nga kushtet e rneposhtme:

- Ofertuesi e ka terhequr ose ka ndryshuar oferten, pas afatit perfundimtar per paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nenshkrimin e kontrates se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille:
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontrates, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Nderkohe, ne formularin e sigurimit te ofertes se dorezuar nga operatori ekonomik eshte modifikuar shtojca 3 duke nderhyre ne oferte, pasi eshte deklaruar se :

- Ofertuesi e ka terhequr ose ka ndryshuar oferten, pas afatit perfundimtar per paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka dorezuar nne oferte te pa pergjegjshme
- Ofertuesi ka refuzuar nenshkrimin e kontrates se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille:
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontrates, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Pra, operatori ekonomik ka dorezuar nje formular sigurimi oferte jo te vlefshme, pasi kjo e fundit nuk eshte ne perputhje me formatin e shtojces 3 te dokumenteve te procedures se prokurimit.

Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteret dhe eshte ne kundërshtim me formatin per ISO-t:

1.Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) ateher kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

2.Certifikate e vlefshme e shoqerise ISO 22000 ose me Standardin Shqiptar (SSH) ateher kur kjo eshte e aplikueshme - Sistemet e menaxhimit te sigurise ushqimore. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3.Certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001 ose ISO 45001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) ateher kur kjo eshte e aplikueshme. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

4.Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten te vlefshme ISO 14001 ose me Standardin Shqiptar (SSH) ateher kur kjo eshte e aplikueshme - Sisteme te menaxhimit te mjedisi. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas aktmarreveshjes.

Bazuar ne dyshime te arsyeshme gjykojme se OVK leshues e certifikates ISO nuk eshte e akredituar ne perputhje me nenin 30 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar.

Sori-Al sh.p.k. nuk permbush kriteretper minimumi 2 mjete ne kundershtrim me kerkesat per kualifikim:

5. Operatori ekonomik duhet te disponoje minimumi 2 (dy) mjete transporti frigoriferik, per transportin e produkteve ushqimore, ne pronesi ose me qira, te vertetuar me dokumentacionin perkates, per secilin mjet si me poshte:

➤ Dokumentacioni qe verteton pronesine:

-Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;
ose

-kontrata e shitblerjes;

ose

-kontrata e dhurimit;

ose

-cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

➤ Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira:

-Kontrate qiraje

a) leje qarkullimi,

b) certifikate e kontrollit teknik te mjeteve rrugore,

c) police per sigurimin e detyrueshem te mjeteve,

d) akt miratimi higjeno - sanitar.

Sori-Al sh.p.k. eshte debitor ne sigurime shoqerore e tatime deri ditin e zhvillimit te procedures si dhe nuk ploteson kriterin e meposhtem:

Ka mungesa ne deklaratat e kerkuara per tu paraqitur ne kundershtim me kerkesat e meposhtme:

4. Operatori ekonomik duhet te deklaroje disponimin ose mundesine e disponomit te materialeve dhe mjeteve profesionale te domosdoshme/inventari i imet, te kerkuara ne shtojcen 9 te DT.

5. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kornbetar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

II.7. Në datën 11.06.2020, nëpërmjet shkresës me nr.957/1 prot., datë 05.06.2020, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt : “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k., KPP vlerëson të sqarojë se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, ka ngritur pretendime për sa i përket skualifikimit të ofertës së tij ekonomike si dhe duke kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., ndërsa në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka ngritur pretendime vetëm për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k.

Në kushtet kur nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, konstatohet se bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, i janë pranuar nga autoriteti kontraktor, pretendimet në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke ndryshuar kështu gjendjen e tij juridike në këtë procedurë prokurimi. Rrjedhimisht, sa më sipër argumentuar, KPP gjykon të marrë në shqyrtim ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, pasi ky i fundit legjitimohet për të paraqitur ankesë mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., me arsyetimin se “Konstatohet se, referuar bilanceve te shoqerise "Sori- Al" shpk, megjithese kjo e fundit megjithese per periudhen 2016, 2017, 2018 permbush dy nga tre kushtet kumulative te nenit 41 germa "c" te ligjit nr. 10091/2009 ate te shumes se te ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) ne ate periudhe kontabel arrin ose e kalon shumen prej 100 milione lekesh; si edhe mesataren prej 30 te

punesuar gjate periudhes kontabel nuk ka dorezuar ne proceduren e prokurimit bilancet e shoqerise ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi, pra shoqeruar me raportin e ekspertit kontabel, duke rende ndesh me parashikimet e ligjit te posacem.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 3.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

- *ISHTE:*

1. *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.*

2. *Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.*

BËHET:

1. *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.*

2. *Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.*

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Sori - AL” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 të konfirmuara nga organet tatimore.
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2017 të konfirmuara nga organet tatimore.
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2018 të konfirmuara nga organet tatimore.
- Vërtetim Nr.T01920294 datë 11.03.2020 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë në emër të subjektit “Sori – AL” sh.p.k. ku raportohen të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gëmbra “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur*”.

III.2.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e*

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.6. Referuar dispozitës ligjore në fuqi, nenit 41 i Ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” parashikohet shprehimisht se: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, parashikohet shprehimisht se:*

Neni 41

Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh;*
- ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh;*
- iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

III.2.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. dhe verifikimin nëse ky operator përmbush dy nga kushtet kumulative të parashikuara në ligjin e sipërcituar për auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. konstaton se totali i aktiveve të bilancit për vitin 2016, 2017 dhe 2018 e kalon shumën e përcaktuar nga ligjvënësi.

Gjithashtu referuar vërtetimit Nr.T01920294 datë 11.03.2020 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë ky subjekt ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve për vitet 2016, 2017 dhe 2018, disa herë më shumë se sa vlera e përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Sa më sipër, KPP gjykon se, operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. ka plotësuar dy nga kushtet kumulative të vendosura nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2016, 2017, 2018, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. rezulton se, janë dorëzuar pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2016-2017-2018), kërkesë kjo e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, por këto pasqyra nuk janë të shoqëruara me raportin e audituesit të pavarur në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto kushte KPP gjykon se, ky operator ekonomik nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2016, 2017, 2018.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., me arsyetimin se *“Bazuar ne dyshime te arsyeshme vleresojme Sori-Al sh.p.k. nuk ploteson kriterin e meposhtem duke patur shkelje te afteve te vlefshmerive te kontratave, librezave shendetesore etj. Dokumentacioni i dorezuar per 4 guzhinere, dy krye guzhiniere dhe 26 ndihmes guzhiniere nuk eshte ne perputhje me dokumentet e procedures se prokurimit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 3.3 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është modifikuar si më poshtë:
Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 4:

ISHTE:

4) *Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 32 (tridhjetë e dy) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Janar 2020 - Mars 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:*

- *Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.*
- *Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.*

BËHET:

4) *Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 32 (tridhjetë e dy) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:*

- *Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020.*
- *Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020.*

III.3.2. Në Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 4.1 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

4.1. *Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e meposhtme:*

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	4

2	<i>Mercollog/Kimist/teknolog</i>	1
3	<i>Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi</i>	25
4	<i>Shofer</i>	2
	<i>Total</i>	32

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libere pune, libere shëndetsore.*
- Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libere pune, libere shëndetsore.*
- Për ndihmës kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, libere shëndetsore.*
- Për shoferin: kontratë pune, libere pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.*
- Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhen e kerkuar.*

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, ndër të tjera është paraqitur si më poshtë vijon:

- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020
- Vërtetim Nr. T02024780, datë 09.04.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a.

Në lidhje me punonjësit Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi, është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Shpresa Lamçe, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Naime Drizi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 04.12.2017 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Lola Stojani, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Liljana Burrnazi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2019 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Violeta Kanto, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 20.12.2017 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Lirije Gjata, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me libere pune; Libere shëndetësore)

- Kontratë pune individuale, datë 07.11.2017 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Lindita Ogreni, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Lena Aliaj, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Jollanda Merkaj, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Flutura Arapi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Fatmira Horanlliu, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Donika Buca, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 18.07.2018 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Anila Kananaj, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Dhurata Xhetani, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 15.02.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Nilke Çera, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Elona Musa, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.07.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Elena Velaj, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.08.2018 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Arta Shamet, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Pranvera Truka, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune (dy emra); Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 31.08.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Arta Topi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)

- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Miranda Kurti, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Lulzime Bardhi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore (nuk përcaktohet afati i përfundimit të vlefshmërisë së kësaj librezë)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Gjela Gjetaj, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Alma Thartori, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 11.12.2018 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Ermelida Cobani, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)
- Kontratë pune individuale, datë 01.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit “Sori - Al” sh.p.k. dhe punëmarrësit znj. Valentina Koçi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. (shoqëruar me librezë pune; Librezë shëndetësore)

III.3.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.3.5. Në nenin 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 5, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) “Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.3.7. Nisur nga pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, i cili pretendon se operatori ekonomik “Sori –AL” sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me dokumentat e procedurës së prokurimit për 26 ndihmës guzhinierë, KPP, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit si dhe shtojcës së publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e këtyre dokumentave, vëren se autoriteti kontraktor, në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë, duhet të kenë në stafin e tyre 25 ndihmës kuzhinierë/Shërbyes gatimi, të cilët duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune në këtë profesion. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar që për punonjësit e mësipërm të paraqitet kontrata e punës, librezë pune dhe librezë shëndetsore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., për të përmbushur kriterin e mësipërm, ky i fundit ka paraqitur Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020; Kontratat e punës për 26 punonjës me profesion ndihmës kuzhinierë/Shërbyes gatimi, shoqëruar me librezë pune dhe librezë shëndetësore.

Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., konstaton se për dy nga punonjësit e mësipërm, me detyrë ndihmës kuzhinier/Shërbyes gatimi, nuk është paraqitur dokumentacion i rregullt dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Konkretisht për punonjësin znj. Pranvera Truka, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”, dokumenti Librezë pune figuron me dy emra të ndryshëm, duke krijuar kështu konfuzion dhe paqartësi se në emër të cilit person është lëshuar ky dokument. Vlen të theksojmë se Libreza e punës, është një dokument i rëndësishëm i cili vërteton eksperiencën e punësimit të punëmarrësit dhe lëshohet vetëm në emër të këtij të fundit. Gjithashtu, KPP konstaton se nuk është dorëzuar asnjë dokument tjetër identifikimi shtesë për të faktuar se kjo librezë pune i përket znj. Pranvera Truka, punonjëse pranë shoqërisë “Sori – AL” sh.p.k. me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”. Me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k. për disponimin e punonjësit ndihmës kuzhinier/Shërbyes gatimi, nuk vërtetohet fakti në lidhje me eksperiencën minimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi sqarojmë se plotësimi i këtij kriteri nëpërmjet të gjithë dokumentacionit të

kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, është lidhur në tërësinë e tij dhe duhet parë i plotë për përmbushjen e tij, pasi librezja e punës është dokumenti me anë të të cilit bëhet i mundur verifikimi i faktit të eksperiencës profesionale të punonjësit.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KPP konstaton se për punonjësën znj. Lulzime Bardhi, me detyrë “Nd.Kuzhinier/Shërbyes mence”, në dokumentin Librezë shëndetësore nuk përcaktohet data e përfundimit të vlefshmërisë së këtij dokumenti, e dhënë kjo e cila nevojitet për të verifikuar nëse ky dokument është i vlefshëm apo jo, në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Sa më sipër, KPP, referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, gjykon se, operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k, nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në lidhje me punonjësën Ndihamë kuzhinier/Shërbyes gatimi, pasi për dy prej tyre nuk është paraqitur dokumentacion i plotë dhe i vlefshëm sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Pra, autoriteti kontraktor me anë të dokumentacionin e paraqitur në këtë procedurë prokurimi, nuk vërteton se plotëson numrin prej njëzet e pesë punonjësish ndihmës kuzhinier/Shërbyes gatimi, kërkesë kjo e përcaktuar shprehimisht në dokumentat e tenderit.

III.3.8. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.3.9. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm dhe me eksperiencë për realizimin e kontratës objekt shqyrtimi, gjë, e cila nuk vërtetohet me dokumentacionin e paraqitur, pasi konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacion i vlefshëm për numrin e kërkuar të punonjësve, në kundërshtim me atë që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më sipër argumentuam, KPP konstaton se, operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me 25 punonjës ndihmës kuzhinier/Shërbyes gatimi.

III.3.10. Akoma më tej, vlen të theksojmë se, në rast se operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...].

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sori – AL” sh.p.k., me arsyetimin se *“Pra, operatori ekonomik ka dorezuar një formular sigurimi oferte jo të vlefshme, pasi kjo e fundit nuk është në përputhje me formatin e shtojcës 3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Kreu II *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”*, Seksioni 2 *“Përlllogaritja e ofertës ekonomike”*, pikat 2.5 dhe 2.6, është parashikuar:

2.5. Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

III.4.2. Në shtojcën 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoritetit kontraktor ka kërkuar:

“Shtojca 3

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbylljen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.4.3. Në shtojcën 8, pika 1 gërma “b” “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

b. Sigurimi i ofertes, sipas Shtojcës 3 (në vlerën 2% të fondit të marrëveshjes kuadër);

III.4.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se operatori ekonomik “Sori – AL” sh.p.k. për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: “Formulari i sigurimit të ofertës” me numër serial 047872 lëshuar nga një shoqëri private sigurimi (“Atlantik” sh.a.) me përshkrim si më poshtë vijon “[...]”

Ref-50034-02-11-2020

Data 21.04.2020

Për: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

Në emër të: “Sori – AL” sh.p.k., Nipt: K31510059D

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): e hapur mbi kufirin e lartë monetary

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi, Elbasan dhe qendrat në varësi të tij.”

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr. 6, datë 17.02.2020

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne vërtetojmë se “Sori – AL” sh.p.k., ka derdhur një depozitë pranë Shoqërisë së Sigurimeve “Atlantik” sh.a. me vlerë prej Lekë 5 369 501 (Pesë million e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e një lekë) si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Agjencia e Blerjeve të Përqendruara vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

1. Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
2. Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme;
3. Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
4. Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar 150 ditë

Lëshuar në Tiranë, me 17 Prill 2020.”

III.4.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit,

duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

III.4.6. Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.4.7. Në nenin 49 pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.

a) vlera e sigurimit duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e përllogaritur e kontratës së prokurimit;

b) autoriteti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Këto kërkesa nuk duhet të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sjelljen e ofertuesit që dorëzon një ofertë, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

i) tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;

ii) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

iii) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Në rast se autoriteti kontraktor e ka kërkuar sigurimin e ofertës, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk e pretendon vlerën e sigurimit, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues..

III.4.8. Në nenin 18 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

“Sigurimi i ofertës nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar.”

2. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

3. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:

a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

b) të paguajë shumën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit kontraktor.

4. Nëse sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie të lëshuar nga një bankë, autoriteti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.”

III.4.9. Në nenin 49 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se; b) autoriteti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Referuar interpretimit sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se *lex specialis* ka parashikuar detyrimin e dorëzimit të sigurimit të ofertës nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetarë si një garanci kundrejt autoritetit kontraktor (institucionit publik) në rastet e parashikuar nga neni 49 i LPP dhe neni 18 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. K.P.P. gjykon se është detyrim i autoritetit kontraktor, të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Në lidhje me formën e lejuar të dorëzimit të ofertës, kuadri ligjor në fuqi i ka lënë mundësinë autoritetit kontraktor të përzgjedhë një nga dy format e parashikuar në nenin 18 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar (formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari).

III.4.10. Në nenin 11 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin:

- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formularin për deklarinimin e konfliktit të interesit;
- formulari i informacionit konfidencial¹⁴;
- ofertën ekonomike;
- sigurimin e ofertës, nëse kërkohet;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- ankesa; - njoftimin e fituesit;
- kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e kontratës së lidhur;
- njoftim i anulimit të procedurës¹⁵.

[...]”

III.4.11. Në nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t’u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore.

3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrimit të parashikimit dhe regjistrimit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

- Hartimin e urdhrave të prokurimit;

- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;

- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- Llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;

- Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitetin dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;

- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;

- Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;

- Përcjelljen pranë APP-së të raportimeve mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.

4. Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:

- Hartimin e specifikimeve teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;

- Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme;
- Hartimin e kriterëve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimin e kriterëve të vlerësimit, nëse është rasti;
- Përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si psh: grafiku i lëvrimit).

Në rast se detyrat e sipërpërmendura nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet”.

III.4.12. Komisioni Prokurimit Publik konstaton se, referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., përmbajtja e këtij të fundit është e ndryshme nga “Shtojca 3 Formular i Sigurimit të Ofertës” parashikuar nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e tenderit. Referuar “Shtojcës 3” të publikuar nga autoriteti kontraktor, *inter allia* janë parashikuar rastet në mënyrë shteruese të transferimit në llogarinë e autoritetit kontraktor nga ana e bankës “...nga kërkesa e thjeshtë e autoritetit kontraktor dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;

Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.”

Ndërkohë referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” me numër serial 047872 datë 17.04.2020 dhe është parashikuar se “Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Agjencia e Blerjeve të Përqendruara vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;

Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme;

Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.”

III.4.13. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formular i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti *Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme*, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarte të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të ri të dokumentave standarte të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k., mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-50034-02-11-2020, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe qendrat në varësi të tij*”, me fond limit 268.475.020 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Sori - AL” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, krahas rivlerësimit të procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të vendimit të KPP-së, të kryejë gjithashtu pasqyrimin në SPE të vendimit të KSHA-së, për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Olta Sharra” p.f. dhe “Dion – AL” sh.p.k.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 460 Protokoli

Datë 26.05.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha